



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E ARKIVAVE TË SHQIPËRISË



AGJENCIA SHTETËRORE
E ARKIVAVE E KOSOVËS

Konferenca VII Ndërkombëtare e Arkivistikës
organizuar me bashkëpunimin e
Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave - Tiranë (Shqipëri),
Agjencisë Shtetërore të Arkivave - Prishtinë (Kosovë)
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup (MV)
dhe
Muzeu i Alfabetit të Gjuhës Shqipe – Manastir (MV)

FTESË PËR PJESËMARRJE

Datat: 10-11 qershor 2023

Vendi: Bitola (Manastir), Maqedoni e Veriut

Afati i pranimit të abstrakteve përfundon më 31 mars 2023.

Pas konferencave të zhvilluara në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Sarandë, Tuz (Mali i Zi) dhe Boletin, arkivistët nga të gjitha trevat do të mbledhen këtë herë në Manastir (Bitola) të Maqedonisë së Veriut.

Ky aktivitet organizohet nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup dhe Muzeut të Alfabetit të Gjuhës Shqipe – Manastir (MV).

Qëllimi i kësaj konference është të mbledhë ekspertët dhe studiuesit e arkivave të vendeve shqipfolëse dhe të arkivave të rajonit, të cilët diskutojnë çdo vit për problematikat, metodologjinë e studimit, digjitalizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së përmbajtjes, inovacionin, si dhe vizionit të punës së arkivave në realitet e sotme.

Me këtë rast Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup dhe Muzeu i Alfabetit të Gjuhës Shqipe – Manastir (MV) ftojnë studiuesit, nëpunësit dhe të gjithë të interesuarit e kësaj fushe të marrin pjesë në konferencë me studime, ide dhe propozimet e tyre.

Temat që propozohen për diskutim lidhen specifikisht me arkivistikën, të drejtat e njeriut dhe me historinë e arkivave apo institucioneve arkivore në zonat shqipfolëse.

Veç arkivistëve të rrjeteve arkivore kombëtare, ftesa për pjesëmarrje u drejtohet të gjithë profileve të tjerë të arkivistëve, institucioneve që ruajnë apo atyre që ndërveprojnë me ruajtjen e kujtesës kolektive.

Abstraktet do të pranohen deri më datë 31 mars 2023 në gjuhët shqip dhe anglisht në ark.kosoves@rks-gov.net dhe dpa@arkiva.gov.al .

Për më shumë informacion shikoni njoftimin ne faqet web të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës www.asha-ks.net dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave www.arkiva.gov.al .

Gjuha e kumtesave: shqip, gjuhët e Europës Perëndimore.

Boshte tematike të propozuara:

- Crowd sourcing: konteksti dhe metadatat e dokumenteve të krijuara prej përdoruesit
- Automatizimi i arkivave dhe etika
- Siguria kibernetike dhe administrimi i të dhënave
- Risetë digitale dhe shfrytëzimi i dokumentacionit
- Zhvillimi i njëtrajtshëm përmes bashkëpunimit me komunitetin
- Trashëgimia arkivore e përbashkët, përtej kufijve gjeografikë
- Arkivat, përgjegjësia, aksesit në të dhënat dhe mbrojtja e të dhënave personale
- Bashkëpunimi rajonal në fushën e arkivave dhe trashëgimisë kulturore arkivore
- Trafiku ilegal i trashëgimisë dokumentare
- Etika dhe arkivat
- Ndryshimet klimaterike dhe arkivat
- Trajnimi arkivor dhe përmirësimi profesional
- Turizmi dhe promovimi i arkivave

(Shënim: temat e propozuara nuk janë tituj të detyruar temash apo artikujsh, as kanë qëllim kufizues, por janë vetëm sugjerime tematike.)